


**MARRËVESHJE BASHKIMI ME PËRTHITHJE**  
**MIDIS**  
**SHOQËRISË PËRTHITHËSE MANE TCI SH.P.K**  
**ME**  
**SHOQËRINË E SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K.**

Sot, më 05.01 2021, palët e mëposhtëm bien dakord përsa më poshtë vijon:

- Shoqëria SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3 , kati 8~te, Ap. nr. 3 dhe 4 Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: L22022002F, me kapital të regjistruar me vlerë 5,000,000 Lekë, përfaqësuar nga administratori Znj. Vjola Kambellari, shtetase shqiptare, e lindur më 20.01.1982, në Ersekë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 036319344, dhe me numër personal I25120092S;

*dhe*

- Shoqëria MANE TCI SH.P.K. , një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, kati 8, Ap.nr. 3 dhe 4, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K22203004A, me kapital të regjistruar me vlerë 689,750,000 Lekë, përfaqësuar nga administratori Z. Erion Avram, shtetas shqiptar, lindur më 12.06.1978, në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 030548648, dhe me numër personal H80612140L; **duke parashtruar se :**
  - A. BALFIN SH.P.K. zotëron 100% të kapitalit të SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K. SH.P.K.;
  - B. BALFIN SH.P.K. zotëron 100% të kapitalit të MANE TCI SH.P.K.;
  - C. raporti/ projekt marrëveshja e bashkimit të shoqërive MANE TCI SH.P.K. dhe SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K. është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me datë 01.12. 2020 dhe numër ështëje CN-622718-11-20;
  - D. me datë 05.01.2021, shoqëritë MANE TCI SH.P.K. dhe SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K., me vendimet respektive të asamblesë së përgjithshme sikurse më sipërshënuar, kanë aprovuar bashkimin nëpërmjet përthithjes së shoqërive SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K. (në vijim "**shoqëria e përthithur**") nga shoqëria MANE TCI SH.P.K. (në vijim "**shoqëria përthithëse**"), duke miratuar, ndër të tjera, edhe projektin e bashkimit të publikuar dhe regjistruar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi; dhe



E. tashmë, sipas nenit 216, paragrafi 3, dhe nenit 225, paragrafi 2, Ligjit nr. 9901, me datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (në vijim "Ligji Tregtar"), është e mundur të procedohet me ekzekutimin e marrëveshjes së bashkimit.

**Duke u mbështetur në këto kushte** që konsiderohen pjesë thelbësore dhe integruese e këtij akti palët bien dakord për sa më poshtë:

1) Shoqëritë MANE TCI SH.P.K. dhe SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K. deklarohen dhe konsiderohen të bashkuara nëpërmjet përthithjes së shoqërise SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K. nga shoqëria MANE TCI SH.P.K. mbi bazën e vendimeve respektive të asamblesë së përgjithshme me datë 05.01.2021.

2) Rrjedhimisht, duke u mbështetur në sa më sipër, shoqëria MANE TCI SH.P.K. zëvendëson me të drejta të plota shoqërinë SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K. në pasurinë e saj aktive dhe pasive, si dhe në të gjitha pretendimet, çështjet gjyqësore, të drejtat, kontratat, detyrimet dhe debitë e cilësdo natyre qofshin, duke marrë përsipër të shlyejë dhe shuajë të gjitha debitë eventualisht ekzistuese brenda afateve përkatëse.

3) Me anë të këtij akti, autorizohet çdo ent apo organ tjetër kompetent i administratës publike, person juridik publik apo privat që të transferojnë dhe të zëvendësojë titullaritetin në të drejta e sende dhe vendosjen e tyre në emër të shoqërisë MANE TCI SH.P.K.. Më specifikisht autorizohet kalimi në emër të shoqërisë MANE TCI SH.P.K. i çdo pasurie të luajtshme apo të paluajtshme, të prekshme apo të paprekshme, akti, dokumenti, garancie, police, licence, lejeje dhe kontrate e cilësdo natyre qoftë, llogari aktive apo pasive të zotëruar nga shoqëria SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K., pa qenë e nevojshëm të lëshohen autorizime apo të kryen formalitete të mëtejshme për këtë qëllim.

3) Me ekzekutimin e bashkimit të shoqërive në fjalë, gjejnë zbatim të plotë vendimet e asambleve përkatëse miratuar me datë 05.01.2021.

4) Në veçanti, sikurse rezulton nga raporti/projektmarrëveshja e bashkimit dhe vendimet e asambleve përkatëse:

- a. nuk do të ketë ndryshime në statutit të shoqërisë përthithëse;
- b. kapitalit i shoqërisë përthithëse (MANE TCI SH.P.K) do të zmadhohet me një vlerë prej 5,000,000 LEKE dhe pas përthithjes do të bëhet 694,750,000 LEKE;
- c. nuk është përcaktuar raporti i këmbimit të kuotave;
- d. kuota e shoqërisë përthithëse (MANE TCI SH.P.K.) nuk do të shpërndahen (caktohen) në një mënyrë të ndryshme, ndërsa kuota që përbën kapitalin themeltar të shoqërisë së përthithur SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K. - e zotëruara tërësisht nga ortaku i vetem i shoqërisë përthithëse - do të anulohen.

5) Data nga e cila marrëveshja e bashkimit shpalos efektet e saj dhe hedhja operacioneve të shoqërive të përthithura në bilancin e shoqërisë përthithëse përcaktohet sipas parashikimeve të

nenit 220, paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Tregtar. Pra, efektet e bashkimit në raport me kalimin e aktiveve dhe pasive të shoqërive të përthithura hyjnë në fuqi nga data e kryerjes së regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Ndërsa, për qëllime kontabël dhe fiskale efektet e bashkimit rrjedhin nga data 30.09.2020, si edhe përcaktuar në projekt marrëveshjen e bashkimit.

6) Pushojnë së ekzistuari organet e shoqërisë SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K. dhe të gjitha prokurat eventuale lëshuar në emër dhe për llogari të tyre, ndërsa organi administrativ i shoqërisë përthithëse do të qëndrojë në detyrë deri në përfundimin e afatit të caktuar.

7) Shoqëria e përthithur SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K., autorizon në mënyrë të pakthyeshme shoqërinë përthithëse MANE TCI SH.P.K. të kryejë çdo veprim, procedurë apo formalitet të nevojshëm dhe oportun me qëllim njohjen e saj si titullare ekskluzive të çdo aktiviteti ekonomik të shoqërisë së përthithur dhe ta zëvendësojë atë me te drejta e plota në çdo raport aktiv dhe pasiv të krijuar prej tyre.

8) Pavarësisht nga sa më sipër, MANE TCI SH.P.K. nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjorë merr përsipër t'i japë çdo kreditori eventual që ngre pretendime, brenda afateve të përcaktuara në nenin 221 të Ligjit Tregtar, të gjitha garancitë e parashikuara në nenin 221, paragrafi 1, Ligjit Tregtar.

\*\*\*\*

Kjo Marrëveshje u hartua prej palëve të cilat e deklarojnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë.

MANE TCI SH.P.K.

*Erion Avram*

Erion Avram - Administratori i Vetëm

SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E.) SH.P.K.

*Viola Kambellari*

Viola Kambellari - Administratori i Vetëm

